

„Purzelbaum“ Një koncept për më shumë lëvizje në kopshtin e fëmijëve...



Lëvizja të shkathëson.

Lëvizjet e rregullta ndihmojnë për trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive motorike dhe cilësive perceptuese të shqisave. Ato shërbejnë që trupi të kundërveprojë në mënyrë të drejtë ndaj sfidave të gjithanshme të jetës së përditëshme.

Lëvizja të bën të fuqishëm.

Duke i ngarkuar në mënyrë të përshtatshme muskujt, tendinat dhe gjymtyrët arrihet stabilizimi i aparatit fiziologjik të lëvizjes, gjë që pakëson rreziqet e dëmtimeve nga qëndrimet e gabuara si edhe dhimbjet kronike.

Lëvizja sjell gëzim (dhe shokë).

Fëmijët me anën e lëvizjeve që bëjnë gjatë lojrave dhe shpërthimeve të rrëmujshme hyjnë në kontakte me fëmijët e tjerë dhe mësojnë si të sillen me njëri-tjetrin. Këtë përbën një bazë të rëndësishme për zhvillimin e tyre të shëndetshëm social dhe emocional.

Lëvizja të mban të shëndetshëm.

Lëvizjet ndihmojnë për parandalimin e sëmundjeve të zemrës, të qarkullimit të gjakut dhe metabolizmit.

Lëvizja të bën të mençur.

Lëvizjet ndihmojnë që fëmijët të njihen me mjedisin rrethues. Këto përvoja kanë një rëndësi thelbësore për përsosjen e aftësive të të menduarit. E rëndësishme është që vetë fëmijët të realizojnë dhe përvetësojnë hapësira të lira.

Lëvizja ndihmon që edhe të rriturit të jenë aktiv.

Njerëzit, që qysh në fëmijërinë e tyre gjejnë kënaqësi tek lëvizjet, janë më pak të rrezikuar të mbajnë një qëndrim trupor pasiv në moshën e rritur. Veç kësaj edhe prindërvë u jepet një shans për të gjetur (sërisht) bashkë me fëmijët e tyre kënaqësinë që të japin lëvizjet.

Synimet:

- Fëmijët lëvizin më shpesh në kopshtin e fëmijëve dhe njohin kështu më mirë veçantitë e trupit të tyre. Kështu ata shkathësohen më tepër dhe e kanë më të lehtë për të luajtur hopthi (Purzelbäumen), për të mbajtur drejt-qëndrimin dhe për t'u kacavjerrë.
- Në parim, lëvizjet bëhen në çdo kohë dhe gjithkund e jo vetëm gjatë orëve të posaçme të ushtrimeve.
- Personeli mësimdhënës i kopshteve të fëmijëve njih format e ndryshme dhe pasojat e lëvizjeve dhe prandaj është në gjendje t'u japë fëmijëve edhe kënaqësinë që buron prej tyre.
- Në këtë koncept do të përfshihen edhe prindërit. Gjatë një takimi me prindër ju do të mësoni se si do të mund ta vini në jetë edhe në banesën tuaj dhe gjatë kohës suaj të lirë idenë e „Purzelbaum“ (lojës hopthi).

Elementë:

- Aftësimi i mëtejshëm i personelit mësimdhënës gjatë 5 gjysëm ditësh
- Aktivitete me prindër
- Ristrukturimi i kopshtit të fëmijëve në funksion të lëvizjes
- Oferta ditore që synojnë lëvizjet
- Këmbimi i organizuar i përvojës midis personelit të aktivizuar mësimdhënës

Ecuria:

- Shkollimi i personelit mësimdhënës të kopshteve të fëmijëve
- Ristrukturimi i ambienteve të kopshteve të fëmijëve
- Ristrukturimi i kopshtit të fëmijëve në funksion të lëvizjes
- Zbatimi në kopshtet e fëmijëve/aktivitetet e prindërvë